VENDIM
Nr.295, datë 24.5.2006

PËR NDRYSHIMIN DHE KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË OBJEKTIT "DEPO" E DPE-SË, NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR, KAMËZ, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, MINISTRISË SË BRENDSHME DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.250, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekti "Depo" e DPE-së, në Universitetin Bujqësor, Kamëz, së bashku me truallin funksional të tij, me sipërfaqe 621 m^2, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, t'i kalojë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme.

2. Objekti "Depo" e DEP-së, në Universitetin Bujqësor, Kamëz, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi, t'i shtohet listës, që i bashkëlidhet vendimit nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik".

3. Ngarkohet Ministri i Brendshëm, Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha